

Database të ndryshme publike sugjerojnë që adresa IP, (vendos numrin), mund të jetë një server postar, i hapur, me ritransmetues ose nje server i hapur, i autorizuar.

Ne mendojmë që ju keni nje server që përdor adresën IP. Ky e-mail përmban informacion të rëndësishëm, i cili mund të ketë ndikim në paraqitjen online të organizatës tuaj.

Ne po jua dërgojmë këtë e-mail si pjesë të projektit të përbashkët të Komisionit Federal të Tregtisë të Shteteve të Bashkuara dhe agjensive të tjera nëpër botë “Veprimi i sigurimit të serverit tuaj”, të cilat janë të shqetësuara për problemet e shoqëruara me përhapjen e e-mail të padëshirueshme tregtare (spam). Ne duam që ju të mësoni sesi të siguroni serverat tuaj dhe të shmangni të qënit burim i paqëllimtë i spam-it. Si hap të parë duam t’ju sugjerojmë mbylljen e serverave të hapur me ritransmetues ose të autorizuar.

Serverat e hapur me ritransmetues ose të autorizuar janë servera që lejojnë cdo kompjuter në botë të dërgojnë e-mail nëpërmjet tyre në adresa të ndryshme interneti. Serverat e hapur me ritransmetues ose të autorizuar shfrytëzohen shpesh nga njerëz që navigojnë në internet me spam-e. Ky abuzim krijon probleme për konsumatorët në mbarë botën si edhe për zbatimin e ligjit dhe për organizatën tuaj. Për shembull, marrësit mund të mendojnë që spam-et vijnë nga sistemi juaj; palët e treta të panjohura mund të përdorin serverat tuaj dhe burimet e shërbimit të internetit; lidhjet në rrjetin tuaj mund të mbeten të bllokuara në trafik; kostot tuaja administrative mund të rriten; ose siguruesi i shërbimit tuaj të internetit mund të mbyllë shërbimin tuaj te internetit. Sigurimi i serverit tuaj do t’ju ndihmojë të mbroni sistemin tuaj nga abuzimi.

Ne ofrojmë informacion shtesë rreth serverave te hapur me ritransmetues ose te autorizuar dhe si të mbroni organizatën tuaj nga rreziqet që shoqërohen nga keto servera të pasiguruar, duke përfshirë këtu hap pas hapi instruksionet për mbylljen e tyre. Klikoni në [www.ftc.gov/secureyourserver](http://www.ftc.gov/secureyourserver) për të parë faqen perkatëse të web, përfshirë këtu edhe listën e agjensive partnere në këtë projekt. Për akses të drejtpërdrejtë në instruksionet për mbylljen e serverave te hapur me ritransmetues ose të autorizuar, klikoni në [www.ftc.gov/bcp/online/pubs/buspubs/secureyourserver.htm](http://www.ftc.gov/bcp/online/pubs/buspubs/secureyourserver.htm). Nëse keni pyetje rreth instruksioneve ose rreth kësaj letre lutemi shkruani në adresën [secureyourserver@ftc.gov](mailto:secureyourserver@ftc.gov).